



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 465/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Partia Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

Me datën 03.11.2013, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se subjekti politik LDK-në Ferizaj përmes shtabit qendror zgjedhor ka lëshuar një komunikatë kinse zëvendësministri i MASHT Nehat Mustafa ka qëndruar në oborrin e shkollës fillore "Gjon Serreqi" duke u ber presion votuesve. Veprimi i tillë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 3 pika a), b) dhe k) neni 5 pika 5.1,5.2 dhe 5.3 si dhe Rregulla Zgjedhore nr.11/2013 dhe neni 4.1 të LZP-së, thuhet në pretendimet e ankuesit .

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik LDK në kuptim të nenit 4, paragrafi 3, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 04.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.11.2013, në ora 19:00. PZAP-i, nuk mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK sipas afatit të caktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me nenin 118.4 LZP-së, parashihet se: *“Mund te apeloheh vendimet e PZAP-it, sikurse PZAP-i mund ti rishikoj cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar”*.

PZAP-i konstatoi se pretendimet e subjektit politik PDK, kanë mungesë të provave të mjaftueshme, për shpifjen e pretenduar nga ana e subjekti politik të LDK-së. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante , andaj në kuptim te nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 465/2013 më datën 07.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala**



Këshillë Juridike: *Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*